



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Gramoz RUÇI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE
PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2020**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Institutit;

Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës tonë kolektive,

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri gjatë vitit 2020 në këto drejtime:

- Informimin publik për krimet e komunizmit përmes rikrijimit të trashëgimisë materiale të komunizmit përmes projekteve dixhitale.

- Rritjen e veprimtarisë në sektorin e edukimit shkollor të të gjitha niveleve, me gjetjen e formave sa më interaktive të përcjelljes së historisë së komunizmit, për një impakt sa më të fuqishëm tek të rinjtë.

- Sensibilizimin publik dhe institucional për trashëgiminë materiale të periudhës komuniste dhe rëndësinë e saj, si dhe vitalizimin e kësaj trashëgimie përmes dokumentimit filmik dhe ekspozitave.

- Evidentimin e rasteve të reja të persekutimit, dënimeve me burg dhe internim përmes zgjerimit të databasës dhe numrit të ri të Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Komunizmit.

- Vazhdimësisë së projekteve afatgjata në lidhje me kërkimin arkivor dhe dëshmitë verbale, siç është pasurimi i databasës dhe arkiva e video-regjistrimeve.

-Ndërkombëtarizimin e historisë së komunizmit në Shqipëri përmes projekteve ndërkombëtare të bashkëpunimit si pjesë e rrjetit të Platformës Europiane të Kujtesës.

Kuvendi kërkon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të aplikojë forma inovative të pasqyimit të veprimtarisë së Institutit brenda vendit, si dhe jashtë tij, si pjesë e rrjetit të institucioneve të Platformës Europiane të Kujtesës.

2. Të rrisë numrin e botimeve të reja nga transkriptimi i arkivës audio-vizuale të ISKK-së.

3. Të rrisë volumin e prodhimeve digjitale duke mundësuar sa më shumë aksesim online të materialeve që ISKK prodhon.

4. Të hartojë menjëherë një plan strategjik për veprimtarinë e ISKK-së për caktimin e prioritetëve dhe objektivave afatgjatë, e më pas detajimin në një plan konkret veprimi.

5. Të rinovojë marrëveshjen me ministrinë përgjegjëse për arsimin, me qëllim rritjen e aksesit në sektorin e edukimit shkollor për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri.

6. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucione homologe të huaja, me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira nga veprimtaria e tyre.

7. Të hartojë Kodin Etik dhe Rregullat e Sjelljes për institucionin.

8. Në funksion të transparencës dhe informimit, të bëjë publike në faqen online të institucionit, si dhe në raportin vjetor që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë të gjithë procedurën e rekrutimit të Këshillit Shkencor dhe veprimtarinë e tij, si dhe formularët e vetëdeklarimit të personave që janë pjesë e organeve drejtuese të institucionit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Miratuar në datën 7.7.2021